

20131643953

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11, 53/11 dhe 123/12), në nenin 30 paragrafi 4 fjalët: "Komisionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhje të punëve administrative në shkallë të dytë nga sfera e turizmit" zëvendësohen me fjalët: "Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë".

Neni 2

Në nenin 65 paragrafët 2 dhe 3 ndryshohen si vijojnë:

“Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.